



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK
DREJTORIA JURIDIKE DHE E INTEGRIMIT

Të dhëna mbi Vendimin

Nr. 22, datë 12.03.2019

Agjencia e Prokurimit Publik (në vijim "APP") në mbështetje të nenit 13/3 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar (në vijim "LPP"), në ushtrim të kompetencave të saj ka nisur procedimin administrativ për përjashtimin e operatorit ekonomik "ERSI/M" Shpk nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit publik.

I. Operatori ekonomik ndaj të cilit ka nisur procedimi administrativ (Emri i subjektit NIPT, adresa):

"ERSI/M" Shpk, me NIPT J98624803O, me adresë: Rruga "5 Shkurti", Ballsh, Fier.

II. Arsytet e fillimit të procedimit administrativ:

Procedimi administrativ ndaj operatorit ekonomik "ERSI/M" Shpk ka nisur mbi bazën e kërkesës Nr. 3829 Prot., datë 16.11.2018, të dërguar nga Bashka Divjakë, me të cilën kjo e fundit i propozon APP-së nisjen e hetimit administrativ ndaj operatorit ekonomik "ERSI/M" Shpk, për përjashtimin e tij nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit publik, në zbatim të nenit 13/3/ç të LPP.

III. Gjetjet:

Në përfundim të procedimit administrativ të nisur, u arrit në konkluzionin se ndodheshim në kushtet e *mospërmbushjes së detyrimeve kontraktuale në kontratat publike, brenda afateve të përcaktuara në rregullat e prokurimit*, sipas parashikimeve të nenit 13/3/ç të LPP.

IV. Masat:

Me Vendimin Nr. 22, datë 12.03.2019, Agjencia e Prokurimit Publik ka vendosur të përjashtojë për 1 (një) vit operatorin ekonomik "ERSI/M" Shpk, nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit publik, pasi është vërtetuar fakti se, ky operator ekonomik nuk ka përmbushur detyrimet kontraktuale në kontratën me objekt: "Studim hidrogeologjik për objektin "Ndërtim i Ujësjellësit Grabian në Bashkinë Divjakë", të lidhur me Bashkinë Divjakë.